



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

V E N D I M

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 08. REGJISTRI TË PARAQITUR NË KQZ
NGA PARTIA BINDJA DEMOKRATIKE**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 31.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me

KËRKUES: Partia "Bindja Demokratike"

OBJEKT: Kundërshtimi i Vendimit nr.7 datë 21.05.2019 të KZAZ nr. 46 "Për mosregjistrimin e listës shumëmemërore për Këshillin e Bashkisë Cërrik"

BAZË LIGJORE: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenet 68; 70; 71; 72 73; 124, 143, pika 1, gërma "c" të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e palëve,

VËREN



Nr. 733 i Vendimit Data 31.05.2019 e Vendimit Ora 18:00 e Vendimit
Për shqyrtimin e kërkesës ankimore Nr. 08, datë 31.05.2019, të paraqitur nga Partia Bindja Demokratike

Partia Bindja ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore nr. 08, datë 31.05.2019, me objekt "Kundërshtimi i Vendimit nr. 7, datë 21.05.2019, të KZAZ nr. 46 "Për mosregjistrimin e listës shumëmemërore për këshillin e bashkisë Cërrik propozuar nga subjekti politik Partia Bindja Demokratike, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datë 30 qershor 2019."

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në përputhje me nenet 134 e vijues të Kodit Zgjedhor, në seancën plenare të datës 31.05.2019, ora 18:00, zhvilloi shqyrtimin administrativ të kërkesës ankimore nr. 08 regj., sipas objektit të sipërcituar.

Në mbledhjen e datës 31.05.2019, KQZ përpara nisjes së hetimit administrativ në mbështetje të nenit 135, pika 3 verifikoi legjitimitetin e palëve dhe konstatoi se për ankimin nr. 08 subjekti ankues i vetëm, është Partia Bindja Demokratike.

- Pala ankuese në ankimin e paraqitur në datë 31.05.2019 pretendon se:

Me vendimin nr. 07 datë 21.05.2019 të KZAZ nr. 64, Bashkia Cërrik, ka vendosur mosregjistrimi e listës shumëmemërore për këshillin e bashkisë Cërrik, propozuar nga subjekti Bindja Demokratike, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datë 30 qershor 2019.

Subjekti zgjedhor Partia Bindja Demokratike më datë 13.05.2019, ka depozituar kërkesën për regjistrimin e listës shumëmemërore për këshillin e Bashkisë Cërrik, pranë KZAZ-së.

KZAZ-ja nr. 46 Bashkia Cërrik ka vendosur "Mos regjistrimin e listës shumëmemërore për këshillin e bashkisë Cërrik", të propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Bindja Demokratike, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019 me arsyetimin se dokumentacioni ka korrigjime me dorë të emrave dhe kandidatit me numër rendor 1 znj. Merita Xhika nuk ka qenë banore e Bashkisë Cërrik dhe duhet të hiqej nga lista. Në këto kushte lista nuk është e plotë, është me 20 emra, dhe jo me 21 si parashikon ligji.

Znj. Merita Xhika ka depozituar kërkesën për tu regjistruar pranë KZAZ-së 46 edhe si kandidate për Kryetare Bashkie në Bashkinë Cërrik propozuar nga Partia Bindja Demokratike. Edhe në këtë rast KZAZja 46 me vendimin nr.06, datë 21.05.2019 ka vendosur "Mosregjistrimin e kandidates znj. Merita Xhika me arsyetimin se nuk është banore e përhershme në Bashkinë Cërrik.

Subjekti Partia Bindja Demokratike ka depozituar kërkesë ankimore pranë KQZ-së duke kundërshtuar vendimin e sipërcituar të KZAZ-së "Për mosregjistrimin e kandidates për kryetare bashkie të Bashkisë Cërrik znj. Merita Xhika. KQZ me vendimin nr.653 datë 26.05.2019 ka vendosur lënin në fuqi të vendimit të KZAZ-së 46 "Për mosregjistrimin e kandidates për kryetare bashkie znj. Merita Xhika.

Kundër vendimit të KQZ-së subjekti Partia Bindja Demokratike ka depozituar ankim në kolegjin zgjedhor.

Kolegji Zgjedhor me vendimin nr. 5, datë 30.05.2019 ka vendosur regjistrimin e kandidates znj. Merita Xhika kandidate për kryetare në Bashkinë Cërrik me arsyetimin se kandidatit në datën kur është marrë vendimi nr.6, datë 21.05.2019 i KZAZ nr.46, për mosregjistrimin e saj si Kandidate për Kryetar Bashkie, plotësonte kushtin e kërkuar nga neni 109/3 i Kushtetutës së



Republikës së Shqipërisë, pasi ajo në këtë datë rezulton banore e përhershme e qytetit Cërrrik. Pra momenti kur bëhet verifikimi i kushteve për të kandiduar nuk është data e dorëzimit të dokumentacionit, por data e marrjes së vendimit nga KZAZ.

Duke qenë se shkak i mosregjistrimit të listës shumemëtoze nga KZAZ-ja ishte se, kandidatja me nr. Rendor 1. znj. Merita Xhika nuk plotësonte kushtin e të qenurit banore e përhershme në Bashkinë e Cërrrikut dhe lista shumemëtoze nuk plotësonte numrin e mandateve të këshillit bashkiak, referuar vendimit të sipërcituar të Kolegjit Zgjedhor kandidatja e listës shumemëtoze e subjektit Partia Bindja Demokratike për këshillin e bashkisë Cërrrik plotëson kushtin e kërkuar nga neni 109/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Duke qenë në këto kushte e gjithë lista shumemëtoze e depozituar nga subjektit Partia Bindja Demokratike, është në përputhje me nenin 67, dhe neni 72, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Për sa më sipër kërkesa ankimore e Partisë Bindja Demokratike është e mbështetur në ligj dhe në prova dhe si e tillë duhet pranuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve referuar nenit 143, pika 1, germa "c" të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, duhet të vendosë ndryshimin e vendimit nr. 078, datë 21.05.2019 "Për mos regjistrimin e listës shumemëtoze për Këshillin e Bashkisë Cërrrik të KZAZ-së nr.46 dhe regjistrimin e listës shumemëtoze të subjektit zgjedhor Bindja Demokratike për këshillin e Bashkisë Cërrrik, që mbyllet me nr rendor 21.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenet 67, 68,70, 71, 72, 73, 124, 143, pika 1, germa "c" të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

V E N D O S I:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 07, datë 21.05.2019 të KZAZ-së nr. 46 "Për mosregjistrimin e listës shumemëtoze për këshillin e Bashkisë Cërrrik" dhe regjistrimin e listës shumemëtoze të Partisë Bindja Demokratike, për këshillin e Bashkisë Cërrrik që mbyllet me numër rendor 21.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

